



Buletini

- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme (PTV)
- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar (PTF)
- * Aktivitetet në Programin për Hulumtime dhe Publikime
- * Aktivitetet për stafin administrativ të gjykatave dhe prokurorive
 - * Aktivitete tjera

Tetor 2017

Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme (PTV)

Matja e dënimit

Më 03 tetor 2017, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme organizoi trajnimin me temën “Matja e dënimit”.



Qëllimi i këtij trajnimi ishte të trajtoj në mënyrë të hollësishme rrethanat që gjykata i merr parasysh për caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit për kryerësin e veprës penale, në mënyrë që ti caktohet ai lloj dhe masë e dënimit, i cili do ti përgjigjet peshës së veprës së kryer penale dhe rrezikshmërisë shoqërore të kryesit, dhe me të cilën më së miri do të arrihej qëllimi i dënimit.

Në kuadër të këtij trajnimi u elaboruan çështjet rreth matjes së dënimeve duke vënë në pah se caktimi i dënimit nga gjykata është si një ndër momentet më të rëndësishme, për të mos thënë finalizuese, të procesit penal. Duke i caktuar veprat penale, Kodi Penal përcakton kufijtë e dënueshmërisë për çdo veprë, cakton llojin dhe lartësinë e dënimit me anë të caktimit të kufirit më të ultë dhe më të lartë të dënimit. Në këtë mënyrë vërtetohen shkallë të ndryshme të rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe kryerësit.

Metodologjia e aplikuar ishte e kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive si dhe punë në grupe e pjesëmarrësve.

Përfitues të këtyre trajnimeve ishin gjyqtarë të nivelit themelor nga të gjitha regjionet e Kosovës.



Shpronësimi dhe kompensimi i pronës së shpronësuar

Me datë 04 tetor 2017, Akademia e Drejtësisë, realizoi trajnimin me temë “Shpronësimi dhe kompensimi i pronës së shpronësuar”.



Qëllimi i këtij trajnimi ishte thellimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me procedurën e shpronësimit dhe kompensimin e pronës së shpronësuar.

Në pjesën e parë të trajnimit u trajtuan çështjet që lidhen me organin kompetent për shpronësim dhe procedura e cila duhet t'i paraprijë shpronësimit. Ndërsa në pjesën e dytë u trajtua procedura e vlerësimit të pasurisë e cila është objekt i shpronësimit, dhe caktimi i kompensimit.

Gjatë këtij trajnimi janë përdorë metoda të kombinuara të shpjegimit, duke përfshirë shpjegime teorike të përcjella me shembuj praktik, ku pjesëmarrësit kanë qenë aktiv, gjë që ka ndikuar në arritjen e objektivave të këtij trajnimi.

Trajnuesit përmes rasteve lidhur me shpronësimin dhe kompensimin e pronës së shpronësuar, kanë arritur t'i shpjegojnë qartë institutet juridike në këtë fushë, me ç' rast është arritur që të identifikohet organi kompetent për shpronësim, janë bërë dallimet e rasteve kur organi shpronësues mund të jetë komuna, e kur organ shpronësues mund të paraqitet qeveria.

Pjesëmarrësit, përmes rasteve në vijim janë njoftuar për mënyrën e zhvillimit të procedurës së shpronësimit, për zbatimin e drejtë të procedurës së vlerësimit të pasurisë, dhe caktimit të kompensimit për pasurinë e shpronësuar me anë të ekspertizës.

Në trajnim morën pjesë gjyqtarët e Gjykatës së Apelit dhe gjykatave themelore - departamenti i përgjithshëm – divizionet civile.



Hetimi financiar

Më 05 deri më 07 tetor 2017, Akademia e Drejtësisë në mbështetje të GIZ-it, realizoi trajnimin me temë “Hetimi financiar”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me zbatimin e kornizës ligjore për pastrimin e parave, mekanizmat ligjor në sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve, masat për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, bashkëpunimi me dëshmitarë, mbrojtja e dëshmitarëve dhe negocimi me të pandehur.

Në sesionin e parë u elaboruan rëndësia e bashkëpunimit me NJIF-in, kompetencat e agjencionit për zbatimin e ligjit për ta kthyer informacionin në dëshmi në kuadër të NJIF-it, si mundet NJIF-i të ndërmarr veprime relevante përpara hapjes së një hetimi penal, qasja e NJIF-it në rrjetin ndërkombëtar, si dhe cilat janë parimet e shkëmbimit të informacionit të pastrimi i parave lidhur me palët në kuadër të NJIF-it.

Në sesionin e dytë u elaborua sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë së përfitur me anë të

kryerjes së veprës penale, mekanizmi ligjor për sekuestrim dhe konfiskim të aseteve, barazimi i prioritetit të dënimit dhe konfiskimit, bazat për sekuestrim dhe konfiskim sipas KPRK, kthimi i pasurisë, si dhe cila është rruga e sekuestrimit dhe konfiskimit sipas Kodit të Procedurës Penale.

Tutje, u elaboruan kushtet për të qenë dëshmitar i mbrojtur, marrja në pyetje e dëshmitarëve të mbrojtur, dëshmitarët anonim, kuptimi i dëshmitarëve anonim, cilat kushte duhet të plotësohen për të qenë dëshmitar anonim, si dhe cilat janë masat mbrojtëse të dëshmitarit dhe llojet e tyre.

Trajnimi u zhvillua në formë interaktive përmes rasteve ku u diskutua rreth sfidave në praktikë dhe vështirësive që gjyqtarët dhe prokurorët hasin gjatë punës së tyre.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelor, prokuror nga PSRK, hetues nga Policia e Kosovës dhe hetues të Njësisë së Inteligjencës Financiare të Kosovës.



“Program i specializuar Trajnimi për Zhvillimin Kapaciteteve në luftën kundër Korrupsionit” sesioni II

Më 06-07 tetor 2017, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, ka realizuar trajnimin me temë “Program i Specializuar Trajnimi për Zhvillimin e Kapaciteteve në Luftën Kundër Korrupsionit“ sesioni II.

Sesioni i dytë i këtij trajnimi kishte për qëllim avancimin e njohurive lidhur me analizat forenzike si dhe përgatitjen e planeve hetuese në koordinim me institucionet relevante në drejtim të luftimit sa më efikas të veprave penale të kësaj natyre.

Gjatë këtij sesioni trajnues u elaborua roli, funksioni dhe struktura e Agjencisë së Kosovës për Forenzikë, metodat e saj të punës, mundësitë që ajo ofron gjatë kërkimit të analizave forenzike nga gjyqtarët dhe prokurorët në këtë Agjenci.

Me theks të veçantë u trajtua përdorimi i masave të fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit për zbulimin e korrupsionit, llojet, kushtet, personat kompetent për të lëshuar këto masa, përmbajtja dhe kohëzgjatja e urdhrave për lëshim të masave si dhe ndihma e organeve tjera për zbatimin e këtyre masave.

Gjatë trajnimit u përdoren metoda interaktive, ku u diskutua rreth sfidave dhe vështirësive specifike që paraqiten si problematike në praktikë në drejtim të zbatimit të drejtë të dispozitave ligjore dhe luftimit të veprave korruptive.

Përfitues të këtij sesioni trajnues ishin gjyqtarë e prokurorë të nivelit themelor, bashkëpunëtorë profesional dhe hetues e zyrtarë nga Policia e Kosovës.



Bashkëpunimi në kryerjen e veprës penale dhe bashkimi kriminal

Më 10 tetor 2017, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme ka realizuar trajnimin me temë “Bashkëpunimi në kryerjen e veprës penale dhe bashkimi kriminal”.



Qëllimi i këtij trajnimi ishte të sqaroj në mënyrë të hollësishme format e bashkëpunimit në kryerjen e veprave penale, analizimin e ndihmës, shtytjes dhe bashkimit kriminal, si

forma me të cilat një numër i konsiderueshëm i veprave penale kryhen, për të cilat në praktikë ka vështirësi në identifikimin e tyre.

Gjatë këtij sesioni trajnues, u shtjelluan çështjet që kanë të bëjnë me bashkëkryerjen dhe marrëveshjen për të kryer veprë penale, shtytja dhe ndihma duke përfshirë bashkimin kriminal, kufijtë e përgjegjësisë penale dhe ndëshkimi për bashkëpunim.

Gjithashtu, nga trajnuesit u prezantuan raste nga praktika gjyqësore si dhe shkëmbimi i përvojave me qëllim të eliminimit të dilemave të cilat shfaqen në praktikë.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelor, si dhe bashkëpunëtorë profesional.



Shqyrtimi paraprak i padisë dhe përgatitja e shqyrtimit kryesor

Me datë 11 tetor 2017, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, realizoi trajnimin me temë “Shqyrtimi paraprak i padisë dhe përgatitja e shqyrtimit kryesor”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte mbështetja e gjyqtarëve për zbatimin e drejtë të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore, lidhur me padinë dhe përgatitjen e shqyrtimit kryesor.

Në pjesën e parë të trajnimit u trajtuan çështjet që lidhen me padinë dhe përmbajtjen e saj dhe dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore, për shqyrtimin paraprak të padisë. Ndërsa në pjesën e dytë u trajtuan veprimet dhe vendimet e gjykatës në shqyrtimin paraprak të padisë dhe llojet e

vendimeve në këtë fazë të procedurës.

Gjatë këtij trajnimi janë përdorë metoda të kombinuara të shpjegimit, duke përfshirë shpjegime teorike, të përcjella me shembuj praktik, ku pjesëmarrësit ka qenë aktiv, për të arritur në tërësi objektivat e këtij trajnimi.

Në trajnim kanë dominuar rastet lidhur me shqyrtimin paraprak të padisë dhe përgatitjen e shqyrtimit kryesor.

Përfitues të trajnimit ishin gjyqtarët e Gjykatës së Apelit dhe gjykatave themelore – të departamenteve të përgjithshme – divizionet civile.



Neni 10 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Me 10-11 tetor 2017, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me projektin “Përforcimi i ekspertizës gjyqësore për lirinë e shprehjes dhe medias në Evropën Juglindore (JUFREX)” realizoi trajnimin dy ditorë me temë “Neni 10 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.

Ky trajnim kishte për synim t’iu ndihmojë pjesëmarrësve të kuptojnë natyrën juridike të lirisë së shprehjes, të analizojnë dispozitat kushtetuese dhe ligjore në fuqi mbi të drejtat e lirisë së shprehjes, mbështetur edhe në kërkesat e KEDNJ-së, të njohin efektet që prodhon neni 10 i KEDNJ-së në sistemin vendor për krijimin e praktikës juridike gjyqësore, përfshirë edhe këshillat praktike se si të veprohet dhe si të gjykohet në rastet lidhur me lirinë e shprehjes dhe të kenë më të lehtë zbatimin e KEDNJ-së, si dhe balancimin e së drejtës së lirisë së shprehjes ndaj të drejtës për lirinë në jetën private sipas praktikës së GJEDNJ-së.

Gjatë këtij trajnimi u trajtuan çështje lidhur me

të drejtat dhe kushtet për kufizimin e lirisë së shprehjes, aktet me të cilat mbrohet liria e shprehjes, roli i gjyqtarëve dhe prokurorëve në mbrojtjen e lirisë së shprehjes dhe medias. Po ashtu u diskutua për aplikimin e urdhrave administrativ të dalë nga neni 10 i KEDNJ lidhur me lirinë e shprehjes dhe qasjes në informata, si dhe mbrojtjen e burimeve në sistemin gjyqësor të Kosovës.

Vëmendje e veçantë iu kushtua edhe punës në grupe, ku pjesëmarrësit kishin rastin të shtjellojnë shembuj nga praktika e GJEDNJ-së.

Kjo mënyrë ka shërbyer njëkohësisht për të nxitur pjesëmarrësit që t’iu referohen aktgjykimeve të GJEDNJ-së kur kanë të bëjnë me raste të ngjashme, në mënyrë që të merret vendim meritor lidhur me rastet e kësaj natyre.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelor dhe zyrtarë ligjor.



Barazia gjinore në procedurë gjyqësore

Me datën 12 tetor 2017, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me GIZ-it mbajti tryezën e rumbullakët me temë: “Barazia gjinore në procedurë gjyqësore”.



Qëllimi i realizimit të kësaj tryeze ishte prezantimi i të gjeturave të hulumtimit rreth vendimeve gjyqësore që kanë të bëjnë me barazinë gjinore në praktikën gjyqësore të Republikës së Kosovës.

Diskutimi i zhvillua në dy pjesë: në pjesën e parë u diskutua për nevojat e hartimit të një doracakut me formular të aktvendimeve si dhe aktgjykimeve në fushën e barazisë gjinore. Ndërsa në pjesën e dytë është diskutuar përfshirja e temave për barazinë gjinore, me fokus në shkrimin dhe arsyetimin ligjor dhe zbatimin e konventave ndërkombëtare, në kurikulen trajnuese për vitin 2018.

Analiza që u prezantua kishte për qëllim analizën e aktvendimeve për urdhra për mbrojtje nga ana e gjykatave të Kosovës në rastet e dhunës në familje si dhe aktgjykimet me rastin e zgjidhjes së martesës me shkurorëzim.

Kjo analizë e vendimeve gjyqësore për periudhën 2016 dhe 2017 është bërë me kërkesë të GIZ-it, Projektit për Reformë Ligjore dhe Administrative. Duke u nisur nga interesi i identifikimit të problematikës në fjalë, analiza u përqendrua në Gjykatën Themelore të Prishtinës dhe Gjykatën Themelore të Ferizajt.

Pjesëmarrës tryeze ishin: gjyqtarë të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatave Themelore nga Departamenti i Përgjithshëm - divizioni civil, divizioni për kundërvajtje, Departamenti për Krime të Rënda, Departamenti për të Mitur, Departamenti për Çështje Ekonomike, zyrtar nga Agjencia për Barazi Gjinore, Fakulteti Juridik UP “Hasan Prishtina”, Qendra Kosovare për studime gjinore (QKSGJ), Policia e Kosovës dhe zyrtarë të GIZ-it.



Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në kontestet martesore - familjare

Më 13-14 tetor 2017, Akademia e Drejtësisë me mbështetje nga UNICEF ka realizuar trajnimin me temë “Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në kontestet martesore - familjare”.

Qëllimi i këtij trajtimi konsiston në avancimin e njohurive në zbatimin e drejtë të dispozitave ligjore dhe akteve tjera normative, si dhe instrumenteve ndërkombëtare për çështjet që i referohen procedurës gjyqësore në dhënien e mbrojtjes juridike për të drejtat e fëmijëve në kontestet martesore – familjare.

Në kuadër të këtij trajnimi, fillimisht, u elaboruan çështjet rreth mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në kontestet martesore-familjare, parimet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në konteste martesore-familjare, roli i gjykatës

dhe institucioneve tjera të cilat e ndihmojnë punën e gjykatës në funksion të mbrojtjes së të mirë të të drejtave të fëmijëve.

Më tej, trajnimi u fokusua kryesisht në zbatimin e Ligjit për Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijës, pasi që rrëmbimi ndërkombëtarë i fëmijëve është një fenomen i cili kryesisht vije si pasojë e vendosjes së qytetarëve të Kosovës në shtetet e huaja, lidhjes së bashkësive martesore dhe zgjidhja e martesës.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: gjyqtarë të gjykatave të nivelit themelor dhe bashkëpunëtorë profesional.



Trajtimi i rasteve të dhunës ndaj mediave

Me 13 tetor 2017, Akademia e Drejtësisë në mbështetje të OSBE-së, ka realizuar trajnimin me temë “Trajtimi i rasteve të dhunës ndaj mediave”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte ngritja e njohurive të pjesëmarrësve rreth përkufizimit të dhunës ndaj mediave/gazetarëve, specifikave të rasteve krahasuar me veprat penale tjera, fuqizimi i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të zbatimit të ligjit lidhur me rastet e dhunës ndaj mediave, që të mundësojë një qasje institucionale dhe të unifikuar për ti identifikuar dhe hetuar rastet e dhunës ndaj mediave.

Pjesëmarrësit diskutuan rreth sfidave që lidhen me rritjen e rasteve të dhunës ndaj mediave, dhe rëndësinë e rasteve kur gazetari sulmohet si qytetar për ndonjë çështje personale dhe deklarohet se është sulmuar si gazetarë pra,

duhet të dihet qartë motivi i sulmit.

Gjithashtu, pjesëmarrësit morën informacion të mjaftueshëm lidhur me iniciimin e rastit penal, fazën parapenale, procedurën paraprake, ndarjen e shkresave sipas natyrës së tyre, masat e fshehta dhe teknike të hetimit dhe vëzhgimit si dhe ndihma nga organet tjera për zbatimin e këtyre masave, cilat janë detyrat e policisë, prokurorit të shtetit dhe gjykatës lidhur me metodat e hulumtimit të rasteve dhe hapat që duhet të ndërmerren për trajtimin adekuat të këtyre rasteve.

Përfitues të këtij trajnimi ishin prokurorë dhe gjyqtarë të nivelit themelorë nga regjione të ndryshme të Kosovës, si dhe zyrtarë nga Policia e Kosovës.



Aktvendimi dhe arsyetimi ligjor

Më 17 tetor 2017, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, ka realizuar trajnimin nga lëmia kundërvajtëse me temë “Aktvendimi dhe arsyetimi ligjor”.

Qëllimi i këtij trajtimi ishte ngritja e aftësive analitike dhe shkathtësive të pjesëmarrësve për hartimin e akteve dhe vendimeve gjyqësore si dhe ndjekjen e një strukture të caktuar, në mënyrë që çështja ligjore të paraqitet dhe të shqyrtohet në mënyrë të duhur si nga aspekti kronologjik, faktik dhe legal.

Në kuadër të këtij trajnimi, fillimisht, u elaborua përpilimi i aktvendimeve të drejta sipas llojit dhe arsyetimit të ligjshëm, duke e specifikuar se aktvendimi, qoftë dënues apo lirues, duhet të jetë i qartë dhe ligjor si për

palët në procedurë, ashtu edhe për personat e tretë.

Më tutje u diskutua për llojet e aktvendimeve në procedurën për kundërvajtje, përpilimi i drejtë i një aktvendim në arsyetim ligjor, si dhe mënyrat e rregullta të dorëzimit të aktvendimit.

Trajnimi u zhvillua në formë të diskutimeve, ku pjesëmarrësit patën mundësinë që përmes demonstrimit të përpilimit të aktvendimit, të kontribuojnë në krijimin e praktikave uniforme për hartimin e drejtë të aktvendimit dhe arsyetimin ligjor të tij.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë të gjykatave themelore, divizioni për kundërvajtje.



Veprat penale kundër jetës dhe trupit

Më 18 tetor 2017, Akademia e Drejtësisë organizoi trajnimin për gjyqtarë dhe prokurorë nga të gjitha regjionet e Kosovës në temën “Veprat penale kundër jetës dhe trupit”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve për hetimin dhe ndëshkimin e kryesve të këtyre veprave penale dhe zbatimin e drejtë të dispozitave të Kodit Penal përmes diskutimeve dhe prezantimit të praktikave më të mira dhe elaborimit të rasteve nga praktika gjyqësore.

Gjatë këtij trajnimi u theksua se mbrojtja e jetës dhe integritetit fizik të njeriut është primare, andaj për çdo sulm ndaj jetës së

njeriut dhe integritetit të tij fizik, kërkohet reagimi i organeve kompetente, që përveç tjerash realizohet me aplikimin e sanksioneve penale kundër kryesve të këtyre veprave penale.

Trajnimi u zhvillua përmes diskutimeve nga gjyqtarët dhe prokurorët pjesëmarrës lidhur me sfidat në praktikën aktuale, si dhe përmes rasteve dhe detyrave praktike për çështjet e shtjelluara.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelore nga regjione të ndryshme të Kosovës.



Zgjidhja alternative e kontesteve

Më 19 tetor 2017, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, realizoi trajnimin me temë: “Zgjidhja alternative e kontesteve”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte thellimi i njohurive të pjesëmarrësve me kornizën ligjore që e rregullon procedurën e zgjidhjes së kontesteve përmes arbitrazhit, dhe mbrojtjen juridike që gëzojnë palët pjesëmarrëse sipas legjislacionit të Republikës së Kosovës.

Gjatë trajnimit u trajtuan çështjet që lidhen me arbitrazhin duke i specifikuar llojet e arbitrazhit, procedurat alternative në praktikë, kompetencat e gjykatës për shqyrtimin e vlefshmërisë së marrëveshjes së arbitrazhit dhe ndërmjetësimit. Me theks të veçantë u shtjelluan çështjet e njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të arbitrazhit qoftë të tribunaleve

vendore ashtu dhe tribunaleve të huaja.

Po ashtu, u trajtuan edhe mjetet juridike në procedurën e njohjes dhe përmbarimit të vendimeve të arbitrazhit, respektivisht mundësisë së kontestimit (anulimin/mospranimin) të vendimit të arbitrazhit, nga gjykatat në Kosovë.

Trajnimi u realizua përmes prezantimit, diskutimit interaktiv si dhe shembujve praktik ku pjesëmarrësit shkëmbyen përvojat, opinionet ose dilemat në lidhje me trajtimin e këtyre kontesteve.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: gjyqtarë nga Gjykata e Apelit, gjyqtarë nga gjykatat themelore si dhe bashkëpunëtorë profesional e zyrtarë ligjorë.



Markat tregtare

Me 20 tetor 2017, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, realizoi trajnimin “Markat tregtare”.



Qëllimi i këtij trajnimi ishte thellimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me markat tregtare, interpretimin dhe zbatimin e drejtë të dispozitave të Ligjit për Markat Tregtare.

Në pjesën e parë të trajnimit u trajtuan çështjet që lidhen me nocionin e markës tregtare dhe kushtet për regjistrimin e saj, paraqitja grafike dhe dallueshmëria e markave tregtare, kushtet

negative – pengesat absolute dhe relative të regjistrimit të markës tregtare, dhe procedura se si fitohet një markë tregtare.

Ndërsa në pjesën e dytë u trajtuan të drejtat dhe kufizimet e bartësit të markës tregtare, realizimi i të drejtave nga markat tregtare, procedura gjyqësore dhe procedura administrative.

Gjatë këtij trajnimi janë përdorë metoda të kombinuara të shpjegimit, duke përfshirë shpjegime teorike dhe praktike, të përcjella me shembuj praktik, ku pjesëmarrësit kanë qenë aktiv gjatë gjithë kohës së trajnimit, për të arritur në tërësi objektivat e këtij trajnimi. Në trajnim kanë dominuar rastet lidhur me markat tregtare.

Përfitues të trajnimit ishin gjyqtarë të nivelit të Apelit dhe nivelit themelorë si dhe zyrtar ligjor.



Procedura gjyqësore në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme

Më 24 tetor 2017, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme ka realizuar trajnimin me temë “Procedura gjyqësore në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve në interpretimin dhe implementimin e dispozitave përkatëse të Ligjit për Dhomën e Posaçme dhe shtojcës së tij, që i referohen procedurës gjyqësore në DHPGJS.

Gjatë trajnimit u trajtuan çështjet që lidhen me procedurën gjyqësore dhe obligimin e palëve në procedurë, mbrojtjen e palëve në procedurë para Dhomës së Posaçme, procedurën me shkrim dhe atë verbale para Dhomës së Posaçme.

Trajnimi u fokusua në diskutimet dhe çështjet e ngritura nga pjesëmarrësit rreth dilemave lidhur me aplikimin e dispozitës së nenit 24 të shtojcës së ligjit, i cili rregullon çështjen e përfaqësimit të paditësit dhe të paditurës para Dhomës së Posaçme.

Metodologjia për realizimin e trajnimit ishte kombinim i teorisë dhe rasteve praktike gjyqësore të parashtruara nga trajnuesit me qëllim të kontributit në standardizimin e praktikës së punës lidhur me këtë fushë.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: gjyqtarë nga Gjykata Supreme e Kosovës, gjyqtarë nga gjykatat themelore si dhe bashkëpunëtorë profesional.



Shqyrtimi kërkesave të kreditorëve dhe pronësore në procesin e likuidimit

Me datën 25 tetor 2017, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, organizoi trajnimin me temë “Shqyrtimi kërkesave të kreditorëve dhe pronësore në procesin e likuidimit”.


Qëllimi i këtij trajnimi ishte thellimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me shqyrtimin e kërkesave të kreditorëve dhe atyre pronësore në procesin e likuidimit.

Në pjesën e parë të trajnimit u trajtuan çështjet që lidhen me paraqitjen e kërkesave kreditore dhe pronësore në Komisionin e Likuidimit dhe në Dhomën e Posaçme. Ndërsa në pjesën e dytë u trajtua procedura e trajtimit të kërkesave pronësore dhe kreditore në komisionin e Likuidimit dhe në Dhomën e Posaçme.

Gjatë këtij trajnimi janë përdorë metoda të kombinuara të shpjegimit, duke përfshirë shpjegime teorike, të përcjella me shembuj praktik, ku pjesëmarrësit ka qenë aktiv gjatë, për të arritur në tërësi objektivat e këtij trajnimi.

Në trajnim kanë dominuar rastet nga praktika lidhur me shqyrtimin e kërkesave të kreditorëve dhe pronësore në procesin e likuidimit.

Përfitues të trajnimit ishin gjyqtarët nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, gjyqtarët e Gjykatës së Apelit dhe gjykatave themelore – Departamenti i Përgjithshëm – divizioni civil, si dhe zyrtarët e AKP-së.



Udhëzuesi i KE-së për Drejtësinë Miqësore për Fëmijë

Me 25-26 tetor 2017, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, realizoi trajnimin nga fusha e Drejtësisë për Fëmijë me temë “Udhëzuesi i KE-së për Drejtësinë Miqësore për Fëmijë”.

Qëllimi i trajnimit ishte thellimi i njohurive teorike dhe praktike të gjyqtarëve dhe prokurorëve, në zbatimin e drejtë të dispozitave ligjore bazuar në Udhëzimet e Këshillit të Evropës dhe praktikës gjermane, dhe në veçanti Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në drejtim të ndërjegjësimin për integrimin e një perspektive miqësore për fëmijët në administrimin e drejtësisë në legjislacionin vendor.

Në trajnim fillimisht u diskutuan iniciativat dhe praktikat më të mira për mbledhjen, marrjen dhe testimin e provave nga fëmijët në procedurat ligjore (penale, civile dhe administrative), për të siguruar që interesat më të mira të fëmijëve janë konsiderata kryesore në çdo veprim që i prek ata, sepse procedura të tilla mund të jenë stresuese për këdo, e aq më shumë për fëmijët, të cilët mund të traumatizohen nëse procedurat që zhvillohen ndaj tyre nuk janë miqësore.

Më tutje u elaboruan parimet themelore të Konventës së OKB-së dhe Udhëzuesit të KE-së

për drejtësinë miqësore për fëmijë, paraburgimi i cili duhet të kufizohet sa më shumë dhe të zëvendësohet me masa alternative për të mitur.

Gjithashtu u theksua mbështetja jo e mjaftueshme e fëmijëve kur marrin pjesë në një proces penal ose civil, duke u bazuar në rregullimet e gjykatave të cilat nuk janë gjithmonë të përshtatura sipas nevojave të tyre, ku mungon një hapësirë e veçantë për intervistimin e të miturit, e cila do të ndihmonte në parandalimin e të miturit nga konfrontimi i drejtpërdrejtë me të pandehurit ose dëshmitarët në gjykatë dhe sigurimi i informimit të të miturit rreth procedurës, çështje këto të cilat nuk janë ende praktikë e zakonshme te ne.

Një pjesë e këtij trajnimit iu dedikua edhe punës në grupe përmes shtjellimit të disa rasteve praktike, ku pjesëmarrësit patën mundësinë të demonstrojnë njohuritë e tyre si dhe të shkëmbejnë përvojat me trajnuesit ndërkombëtar lidhur me krijimin e praktikave më të mira në drejtim të mbrojtjes së interesit më të mirë të fëmijëve.

Trajnimit është realizuar nga ekspert ndërkombëtarë. Përfitues të këtij trajnimit ishin gjyqtarë dhe prokurorë të niveleve të ndryshme nga Departamenti për të Mitur.



Program i specializuar trajnimi në forcimin e kapaciteteve profesionale në luftimin e krimit kibernetik - Sesioni II

Më 27-28 tetor 2017, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme ka realizuar sesionin e dytë të trajnimit me temë “Program i Specializuar Trajnimi në forcimin e kapaciteteve profesionale në luftimin e krimit kibernetik”.



Qëllimi i këtij sesioni trajnues ishte ngritja dhe forcimi i njohurive të pjesëmarrësve me elementet kyçe dhe tendencat e krimit kibernetik në mënyrë që të ndërtohen dhe fuqizohen kapacitetet profesionale në luftimin e kësaj dukurie negative.

Në kuadër të këtij sesioni u trajtuan provat elektronike, procedura dhe praktika, marrja e provave elektronike, vlerësimi dhe menaxhimi i rrezikut, luftimi i rreziqeve të sigurisë virtuale si posta elektronike, viruset etj. Më tutje, u trajtuan zbulimi dhe parandalimi i pastrimit të parave dhe roli i forenzikës në zbulimin e krimit kibernetikë.

Gjatë trajnimit u përdorën metodat e krahasimit të legjislacionit vendor me atë ndërkombëtarë që e sanksionon krimin kibernetik si dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare në luftimin e kësaj dukurie.

Trajnimi u zhvillua në formë të diskutimeve interaktive, duke vënë në pah sfidat e vështirësitë në praktikë në rastet që ndërlidhen me këtë krimin kibernetik.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelore nga regjione të ndryshme të Kosovës.



Dëshmitarët në procedurën penale

Më 31 tetor 2017, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të PTV-së, realizoi trajnimin me temën “Dëshmitarët në procedurën penale”.



Qëllimi i këtij trajnimi ishte të sqaroj në mënyrë të hollësishme rolin e dëshmitarit në procedurën penale, të cilët luajnë rol të rëndësishëm në zbardhjen e një vepre penale.

Në fokus të trajnimit ishte zbatimi i drejtë i dispozitave të Kodit Penal dhe Kodit të

Procedurës Penale kur kemi të bëjmë me dëshmitarët në procedurën penale.

Në kuadër të këtij trajnimi u elaboruan çështjet rreth e rolit të dëshmitarit në procedurën penale duke përfshirë edhe llojet e dëshmitarëve.

Vëmendje parësore iu kushtua dëshmitarëve të mbrojtur për të cilët ligji për mbrojtjen e dëshmitareve ka paraparë programin e trajtimit të këtyre dëshmitareve.

Metodologjia e aplikuar ishte e kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive si dhe puna në grupe e pjesëmarrësve.

Përfitues të këtyre trajnimeve ishin gjyqtar të nivelit themelor nga të gjitha regjionet Kosovës si dhe nga Policia e Kosovës.



Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve Fillestare (PTF)

Aktivitetet e realizuara në PTF– për prokurorët e sapo emëruar

Akademia e Drejtësisë, ka vazhduar përbushjen e programit të trajnimit për prokurorët e shtetit të sapoemëruar, duke realizuar në këtë formë aktivitete trajnuese të cilat kanë përfshirë trajnimin teorik dhe atë praktik, ashtu siç ishin planifikuar me program.

Komponenta e trajnimit teorik, gjatë muajit tetor, është përbushur duke realizuar aktivitetet si në vijim: në kuadër të nën-modulit “Hetimi i krimeve ndërkufitare” është realizuar një (1) sesion trajnues; në kuadër të nën-modulit “Etikë profesionale” janë realizuar dy (2) sesione trajnuese, me të cilat edhe është përfunduar ky nën-modul.

Në kuadër të nën-modulit “Rregullat e komunikimit” janë realizuar dy (2) sesione trajnuese, ku janë trajtuar: komunikimi dhe rregullat e komunikimit të jashtëm si dhe përvojat më të mira në mjedisin e punës. Po ashtu, janë realizuar edhe dy (2) sesione tranuese nga nën-moduli “Menaxhimi i stresit”, ku ndër të tjera janë elaboruar këto tema: menaxhimi i kohës si predispozitë e menaxhimit të stresit, mbrojtja e shëndetit dhe përmirësimi i cilësisë së punës dhe jetës. Në këtë kuadër, po ashtu janë realizuar edhe dy (2)

sesione trajnuese nga nën-moduli “Administrimi i procedurës penale”, dhe katër (4) sesione nga nën moduli “Ekspertizat dhe analizat”.

Nën-moduli “Negocimi i marrëveshjes për pranimin e fajësisë”, është realizuar përmes tri (3) sesioneve trajnuese, ku ndër të tjera janë elaboruar: inicimi i procedurës për negocimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë; roli i Prokurorit të Shtetit në negocimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë dhe marrëveshja për pranimin e fajësisë në gjykatë.

Nën-moduli “Veprat penale të korrupsionit zyrtar dhe kundër detyrës zyrtare” është realizuar përmes dy (2) sesioneve trajnuese, si dhe është realizuar një (1) sesion nga nën-moduli “Shmangia nga ndjekja penale”, nën-modul ky i cili realizohet në tërësi gjatë muajit nëntor.

Ndërsa komponenta e trajnimit praktik, për këtë periudhë është realizuar përmes vijimit të praktikës nga ana e prokurorëve të sapoemëruar në prokuroritë përkatëse, konform orarit të përcaktuar me program.



Aktivitetet e realizuara në PTF për gjyqtarët e sapoemëruar

Në kuadër të Programit të Trajnimit Fillestar, për gjyqtarët e sapoemëruar, janë zhvilluar aktivitete duke përfshirë trajnimin teorik dhe praktikë.

Në kuadër të trajnimit teorik, në këtë periudhë janë realizuar sesione trajnimi për modulën “Kodi Penal i Kosovës” duke përfshirë pjesën e përgjithshme dhe atë të veçantë. Sa i përket pjesës së përgjithshme, janë zhvilluar gjithsej 8 sesione ku ndër të tjera janë trajnuar: nocioni dhe elementet e veprës penale; objekti dhe subjekti i veprës penale; ndarja e veprave penale; veprimi; vendi dhe koha e kryerjes së veprës penale; kundërligjshmëria; përgjegjësia penale dhe fazat e kryerjes së veprës penale.

Ndërsa, për pjesën e veçantë të Kodit Penal të Kosovës, po ashtu janë realizuar 8 sesione trajnimi, në kuadër të të cilave janë trajtuar këto tema: veprat penale nga kapitulli XIV, XV

dhe hyrje në kapitullin e XVI; veprat penale kundër jetës dhe trupit dhe lirive e të drejtave të njeriut; si dhe veprat penale nga kapitujt XVII, XX, XXIII, XXV, dhe XXVII.

Metodologjia e aplikuar gjatë realizimit të këtyre sesioneve trajnuese ishte e kombinuar, duke përfshirë ligjërime teorike dhe diskutime interaktive, ku gjyqtarët e sapoemëruar ngritën çështje me interes dhe dilema të cilat po ashtu i vërejnë gjatë fazës praktike të trajnimit në gjykatat përkatëse. Përmes detyrave dhe ushtrimeve praktike, ata u angazhuan në përgatitjen dhe prezantimin e rasteve për situata të ndryshme hipotetike.

Në kuadër të trajnimit praktikë, gjyqtarët e sapoemëruar kanë vazhduar praktikën në gjykatat përkatëse konform orarit të përcaktuar me program, nën mbikëqyrjen e mentorëve të tyre.



Aktivitetet në Programin për Hulumtime dhe Publikime

Tryezë pune me gjyqtarët e Gjykatës së Apelit

Më 17-18 tetor 2017, Akademia e Drejtësisë me mbështetjen e projektit "Mbështetje për fuqizimin e sundimit të ligjit" të UNDP-së, ka realizuar tryezën e punës me gjyqtarët e Gjykatës së Apelit për të prezantuar të gjeturat e hulumtimit të praktikës gjyqësore, që vjen si rezultat i shkeljeve, veçanërisht në çështjet civile të natyrës procedurale dhe materiale, dhe si pasojë gjykatat e shkallës së parë dështojnë të nxjerrin një vendim të drejtë dhe të ligjshëm.



Kjo tryezë ishte vazhdimësi e aktiviteteve paraprake të këtij projekti hulumtues me synimin që të kontribuoj në evitimin e këtyre shkeljeve përmes përgatitjes së një udhëzuesi apo doracaku me qëllim të zvogëlimit të trendit të lëndëve të cilat kthehen në rishqyrtim, dhe rritjen e efikasitetit në zgjidhjen e rasteve.

Për dy ditë me radhë gjyqtarët e Gjykatës së Apelit të angazhuar në këtë projekt hulumtues, prezantuan individualisht rastet më të shpeshta që vijnë nga gjykatat e shkallës së parë, të cilat për shkak të shkeljeve qoftë procedurale dhe materiale duhet të kthehen në rishqyrtim.

Në ditën e parë u prezantuan të gjeturat dhe rekomandimet për çështjet e identifikuara nga procedura kontestimore, lidhur me institutin e

parashkrimit, pengimin e posedimit dhe kontestet e punës, lidhur me pronësinë (fitimi me mbajtje) servitutet, shpronësimin, rastet e dhunës në familje, çështjet familjare dhe trashëgimore.

Në ditën e dytë u prezantuan të gjeturat dhe rekomandimet për çështjet e identifikuara nga kontratat, kompensimin e dëmit, përmbarimore, dhe për çështjet lidhur me konfliktin administrativ.

Nga diskutimet e përbashkëta kishte edhe shumë çështje për të cilat Gjykata e Apelit kishte dilema prandaj u diskutua që të konstatohen dhe si të tilla të adresohen te Gjykata Supreme.

Në këtë tryezë morën pjesë kryetari i Gjykatës së Apelit dhe gjyqtarë tjerë nga Departamenti i Përgjithshëm - divizioni civil, Departamenti për Çështje Administrative dhe Departamenti për Çështje Ekonomike.



Aktivitetet për stafin administrativ të gjykatave dhe prokurorive

Menaxhimi i rrjedhës së rasteve

Me 05 tetor 2017, Akademia e Drejtësisë në mbështetje të GIZ-it, ka realizuar trajnimin me temë “Menaxhimi i rrjedhës së rasteve”.



Ky trajnim kishte synim ngritjen e performancës të stafit përkatës administrativ, për një menaxhim efektiv të rrjedhës së rasteve, në përputhje me legjislacionin në fuqi, rregullat dhe rregulloret e brendshme, për faktin se menaxhimi i rasteve është themel i suksesit në punën e tyre të përditshme.

Diskutimet gjatë trajnimit u fokusuan në procedurat standarde të veprimit për menaxhimin e rrjedhës së rasteve, duke potencuar pikat e dobëta dhe të forta në punën praktike për menaxhimin e rrjedhës së rasteve, ndryshimin e praktikave ekzistuese dhe

aplikimin e praktikave të reja të cilat mund të sjellin më shumë rezultate dhe performancë më të mirë dhe me këtë edhe ngritjen e besueshmërisë edhe më të madhe të publikut në sistemin gjyqësor dhe prokurorial.

Si procese me rëndësi në menaxhimin e rrjedhës së rasteve të cilat u elaboruan ishin edhe procedura e përtëritjes së lëndës në rastet kur lënda dëmtohet apo humbet, ruajtja e lëndëve, përpunimi dhe raportimi i të dhënave, respektimi i afateve, monitorimi dhe sigurimi i uniformitetit në praktikën administrative, numri i lëndëve dhe reduktimi i atyre të grumbulluara.

Trajnimi u realizua kryesisht përmes diskutimeve si dhe punës në grupe, ku pjesëmarrësit fillimisht kanë paraqitur problemet praktike gjatë menaxhimit të lëndëve dhe njëkohësisht propozimet për zgjidhjen e problemeve të evidentuara.

Pjesëmarrës në këtë trajnim kanë qenë administratorët, ndihmës administratorët dhe shefat e shkrimoreve të gjykatave dhe prokurorive.



Menaxhimi i kohës dhe stresit

Më 19 tetor 2017, Akademia e Drejtësisë në mbështetje të GIZ-it, ka organizuar trajnimin me temë “Menaxhimi i kohës dhe stresit”.

Ky trajnim kishte për synim të ndihmoj pjesëmarrësit në identifikimin e shkallës së stresit në jetën dhe punën e tyre të përditshme, faktorët e rrezikut të cilat shkaktojnë stresin, fushat për realizimin e mundësive më të mira për të përmirësuar mirëqenien e tyre personale, ngritjen e aftësive profesionale të stafit administrativ për menaxhim më të mirë të kohës, në mënyrë që të ketë një funksionim më efikas dhe më efektiv të sistemit gjyqësor dhe prokurorial.

Trajnimi kryesisht ishte i fokusuar në elaborimin e çështjeve që kanë të bëjnë me mekanizmat mbrojtës, strategjitë e dëmshme dhe teknikat për menaxhimin e stresit, çështjet bazë të stresit dhe psikologjisë së shëndetit, si dhe përballimi i stresit përmes metodave të konfrontimit, kompromisit dhe tërheqjes.

Duke qenë se shpeshherë, një prej shkaktarëve kryesor të stresit, është edhe mungesa e kohës

në dispozicion për të bërë gjithçka që kërkohet brenda afateve të caktuara, një vëmendje e veçantë iu kushtua edhe menaxhimit të kohës, duke i trajtuar shumë çështje që ndihmojnë në reduktimin dhe kontrollimin e stresit të ndërlidhur me punën në kryerjen e detyrave të tyre, siç janë: përmirësimi i menaxhimit të kohës dhe të kryerjes së detyrave të stafit administrativ, delegimi i detyrave, monitorimi dhe respektimi i afateve dhe shumë çështje tjera me rëndësi që ndihmojnë për të tejkaluar pengesat e ndryshme dhe për të arritur një balancë në punë dhe në jetë.

Trajnimi u zhvillua me diskutime interaktive në çdo fazë të tij nga pjesëmarrësit, si dhe me plotësimin e një pyetësoi lidhur me testimin e stresit duke e konstatuar shkallën e stresit individual të pjesëmarrësve por, edhe në total si grup.

Përfitues të trajnimit ishin stafi administrativ gjyqësor dhe prokurorial.



Aktivitetet tjera

Konferencë 20 Vjetori i Shkollës së Magjistraturës së Shqipërisë

Në kuadër të kremtimit të 20 vjetorit të fillimit të veprimtarisë akademike të saj, Shkolla e Magjistraturës e Shqipërisë, organizoi ngjarjen me titull “Magjistratura në Perspektivën Evropiane”, në të cilën mori pjesë u.d. Drejtori i Akademisë së Drejtësisë së Kosovës.

Aktiviteti u zhvillua me datë 2 tetor 2017, me pjesëmarrjen e shumë personaliteteve të shumta të vendit dhe të huaj si dhe drejtues të Institucioneve të Trajnimit Gjyqësor të rajonit të Ballkanit dhe Turqisë.

Pjesë e këtij aktiviteti ishte edhe një konferencë shkencore ndërkombëtare “Magjistratura në Perspektivën Evropiane” e ndarë në dy panele. Paneli i parë pati si temë: “Bashkëpunimi ndërkombëtar në rritjen e kapaciteteve dhe ngritjen institucionale të sistemit të drejtësisë. Roli i Shkollave të Magjistraturës në

perspektivën evropiane”, ndërsa paneli i dytë, temën: “Roli i magjistratit në rritjen e cilësisë dhe efikasitetit të drejtësisë. Pozita para dhe pas ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore”.

Në panelin e dytë, përfaqësuesit e institucioneve të trajnimit gjyqësor prezantuan në tema të ndryshme, ndërsa u.d. Drejtori i Akademisë së Drejtësisë të Kosovës z. Besim Morina, referoi lidhur me temën “Trajnimi i vazhdueshëm i detyrueshëm – e drejtë dhe detyrë e magjistratëve”.

Pjesëmarrja në panelin e parë e Institucioneve të Trajnimit Gjyqësor të rajonit synoi të përcjellë frymën e bashkëpunimit me të gjitha vendet në rajon në dhënien e përvojave individuale dhe ndarjen e të ardhmes së përbashkët Evropiane, parë edhe në kontekstin e secilit vend veç e veç.



Kongresi Ndërkombëtarë për Arsimimin Ligjor

Nga data 4 deri 6 tetor 2017, në Stamboll është mbajtur Kongresi Ndërkombëtar i "Arsimimit Ligjor" i organizuar nga Akademia e Drejtësisë e Turqisë, në të cilin ka marrë pjesë edhe Akademia e Drejtësisë si institucion i cili merret me trajnime në fushën gjyqësore.

Në këtë kongres kanë marrë pjesë, përfaqësues të institucioneve të trajnimit gjyqësor, gjyqtarë dhe prokurorë, dekanë, akademikë dhe studentë nga vende të ndryshme të Evropës dhe Azisë.

Referuesit u ndalën veçanërisht në zhvillimin e arsimimit ligjor në periudha të ndryshme historike, situatën aktuale të arsimimit ligjor në

sisteme të ndryshme në botë, ku u prezantuan arritjet dhe sfidat në fushën e arsimimit ligjor goftë në pjesën akademike e cila realizohet nga institucionet e arsimit, apo edhe pjesën praktike e cila në pjesën më të madhe të vendeve realizohet nga institucionet që merren me trajnimin gjyqësor.

Pjesë e zhvillimeve në kongres ishte organizimi i tryezës së diskutimeve në të cilën kanë marrë pjesë institucionet e trajnimit gjyqësor ku janë prezantuar zhvillimet aktuale, sfidat si dhe janë dhënë rekomandime të ndryshme për avancimin e punës së institucioneve që organizojnë trajnimin gjyqësor.



Punëtori “ Trajnimi fillestar i bazuar në lëndë – Elaborimi i Doracakut për trajnim të bazuar në lëndë”

Më 11 tetor 2017, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Projektin e Binjakëzimit – Mbështetje e mëtejme e reformës për arsimim ligjor, ka realizuar “Punëtorinë për elaborimin e doracakut për trajnimi të bazuar në lëndë”.

Akademia e Drejtësisë dhe ekspertët e binjakëzimit janë pajtuar se një model trajnimi i bazuar në raste do ishte qasje e dobishme dhe e nevojshëm. Menaxhimi i dosjeve të lëndës është një punë e rëndësishme për çdo gjyqtarë dhe prokurorë dhe metodat e trajnimit të bazuar në raste do të mbështesë gjithashtu të mësuarit vetëdrejtues për gjyqtarët dhe prokurorët e sapo emëruar.

Qëllimi i kësaj punëtorie ishte përcaktimi i strukturës së doracakut për trajnim të bazuar në lëndë, kjo strukturë do të përmbajë dy faza: fazën paraprake dhe fazën e gjykimit. Në fazën paraprake përfshinë hapat fillestar dhe hapat përgatitore (varësisht nga procedurat), ndërsa fazën e gjykimit përfshinë procedurën pas aktakuzës, shqyrtimi kryesor dhe mjetet ligjore për procedurën penale ndërsa gjykimin, aktgjykimin dhe ankesën për procedurën civile.

Gjatë punëtorisë fillimisht janë prezantuar rastet e përzgjedhura nga gjyqtarët dhe prokurorët të angazhuar në hartimin e këtij doracakut të cilët u janë përmbajtur udhëzimeve paraprake duke filluar nga thjeshtësimi i çështjes sipas problemeve procedurale relevante, përcaktimi i pyetjeve dhe përzgjedhja e metodave të trajnimit për fazat konkrete.

Bazuar në strukturën e përcaktuar ekspertët kanë shkëmbyer mendime dhe përvoja rreth qasjes së trajnimit të bazuar në raste si zgjedhja e rasteve praktike, shkurtimi i lëndës për tu prezantuar pjesëmarrësve në trajnimin fillestar, strukturimi i rasteve, gjetja e pyetjeve të rëndësishme dhe didaktike.

Pjesëmarrës në këtë punëtori ishin trajnues të Akademisë së Drejtësisë nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve, ekspertë të tjera të angazhuar nga Projekti i Binjakëzimit, dhe stafi i Akademisë së Drejtësisë.



Punëtori për hartimin e draft Rregullores për Organizimin dhe Sistematizimin e Brendshëm të Vendeve të Punës në Akademinë e Drejtësisë

Prej 11 deri me 14 tetor 2017, Akademia e Drejtësisë realizoj punëtorinë për hartimin e rregullores për Organizimin dhe sistematizimin e brendshëm të vendeve të punës në Akademinë e Drejtësisë, që rrjedhë si obligim nga Ligji për Akademinë e Drejtësisë.

Gjatë kësaj punëtorie, Komisioni për Çështje Normative i themeluar nga Këshilli Drejtues i Akademisë së bashku me grupin punues nga staf i Akademisë, përcaktuan metodologjinë e punës, duke dhënë elementet bazë mbi të cilat do të hartohet ky akt dhe në hartuan draftin e Rregullores, duke marrë për bazë funksionet e Akademisë dhe pozitat që e bëjnë funksionale mandatin e Akademisë.

Gjatë analizës dhe diskutimeve të shumta në punëtori, me rastin e hartimit të kësaj Rregulloreje, Komisioni udhëhiqej nga parimet dhe standardet për hartim të akteve juridike me qëllim që ato të jenë të qarta, funksionale dhe të zbatueshme në praktikë.

Në këtë punëtori morën pjesë anëtarët e Komisionit për Çështje Normative si dhe grupi punues nga stafi i Akademisë.



Vizita e juristëve gjerman në Akademinë e Drejtësisë

Më 18 tetor 2017, U.D. Drejtori i Akademisë së Drejtësisë ka pritur në takim një delegacion të



juristëve të rinj të Gjermanisë, i cili është organizuar me iniciativën dhe mbështetjen nga GIZ.

Në këtë takim, z. Besim Morina prezantoi punën e Akademisë, duke njoftuar në detaje për aktivitetet që zhvillon Akademia, rolin, strukturën, bazën ligjore, programet trajnuese dhe mandatin e Akademisë.

Nga ana tjetër juristët e rinj gjerman u shprehën të kënaqur me vizitën që po i bëjnë Kosovës dhe përmes pyetjeve të ndryshme shprehën interesimin e tyre për llojet e trajnimeve si dhe funksionimin e sistemit të drejtësisë në Kosovë.

Në fund të takimit, u diskutua për mundësitë e bashkëpunimit për shkëmbimin e përvojave dhe praktikës në fushën e trajnimeve gjyqësore dhe zhvillimit të kapaciteteve në fushën e gjyqësorit.



Takimi i Këshillit Drejtues të Akademisë

Me datë 19 tetor 2017, në Akademinë e Drejtësisë, u mbajt takimi i gjashtë me radhë i Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë, i udhëhequr nga Kryesuesi i Këshillit Drejtues z. Aleksandër Lumezi, Kryeprokuror i Shtetit.

Sipas agjendës së përcaktuar për këtë takim, fillimisht anëtarët e Këshillit Drejtues miratuan procesverbalin nga takimi i kaluar.

Më pas Këshilli Drejtues miratoi përbërjen e Këshillit Programor të Akademisë së Drejtësisë anëtarë të cilit u emëruan Emine Kaçiku, gjyqtare në Gjykatën Supreme, Mahir Tutuli, gjyqtar në Gjykatën e Apelit, Afrim Shala gjyqtar në Gjykatën Themelore Gjilan, Besim Kelmendi, prokuror në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, Habibe Salihu, prokurore në Prokurorinë Themelore Prishtinë dhe

Prof.Ass.Dr. Haxhi Gashi, Dekan i Fakultetit Juridik, Universiteti i Prishtinës.

Më pas Këshilli Drejtues sipas agjendës vazhdoi me procedurën e zgjedhjes së Drejtorit. Në votim morën pjesë të gjithë anëtarët e Këshillit Drejtues dhe me 8 vota për dhe 1 votë kundër, Drejtor i Akademisë së Drejtësisë është zgjedhur z. Valon Kurtaj.

Në këtë takim Këshilli Drejtues diskutoi dhe miratoi Programin e Trajnimeve për stafin Administrativ të Gjykatave dhe Prokurorive. Gjatë diskutimeve u theksua që ky program është i domosdoshëm dhe i plotëson të gjitha kushtet dhe standardet e një programi të mirëfilltë trajnues.



Ngjarjen e përrurimit të modulit trajnues për luftëtarët e huaj terroristë

Me 20 tetor 2017, Akademia e Drejtësisë me ftesë të Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Drogë dhe Krime (UNODC), dega për Parandalimin e Terrorizmit (TPB), ka marrë pjesë në përrurimin e Modulit Trajnues për Luftëtarët e Huaj Terroristë, e cila u mbajt në Vjenë.

Qëllimi i kësaj ngjarjes promovuese ishte që pjesëmarrësve të ju jep mundësi që të reflektojnë për projektin, diskutojnë integrimin e modulit trajnues për luftëtarët e huaj terroristë në kurrikulën e rregullt trajnuese të institucioneve të trajnimit gjyqësor, dhe të forcojnë bashkëpunimin e ardhshëm mes UNODC dhe institucioneve trajnuese gjyqësore.

Gjatë ngjarjes është prezantuar moduli trajnues në versionin në gjuhën angleze, i cili do të dërgohet te secili institucion trajnues. Gjithashtu janë paraqitur çështjet konkrete të projektit brenda aktiviteteve të UNODC si dhe janë diskutuar përmbledhja e projektit dhe aktivitetet e ardhshme.

Pjesëmarrës në ngjarjen e përrurimit të modulit trajnues për luftëtarët e huaj terroristë ishin: z. Elez Blakaj, Prokuror në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, znj. Ariana Shajkofci, Prokurore në Prokurorinë Themelore në Prizren dhe znj. Melihate Rama, Udhëheqëse e Divizionit të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, në Akademinë Drejtësisë.



Vizita e studentëve nga Gjermania në Akademinë e Drejtësisë

Më 23 tetor 2017, përfaqësues të Akademisë së Drejtësisë kanë pritur në takim një grup prej 16 studentëve nga Gjermania, duke i njoftuar ata nga afër me funksionimin dhe aktivitetet e Akademisë.

Në këtë takim studentët u njoftuan për sistemin e drejtësisë në Kosovë, funksionimin dhe ndarjen e pushteteve, mandatin dhe funksionet kryesore të institucioneve të sistemit të drejtësisë, rolin dhe mandatin e Akademisë së Drejtësisë si dhe çështje tjera që kanë të bëjnë me funksionimin e shtetit ligjor dhe të së drejtës.

Nga ana tjetër studentët gjerman vlerësuan si shumë të rëndësishme vizitën e tyre në Kosovë e veçanërisht në Akademi të Drejtësisë, me ç'rast shprehën interesimin e tyre për të pasur më shumë njohuri për sistemin gjyqësor në Kosovë me theks të veçantë për punën e Akademisë së Drejtësisë.

Kjo vizitë u realizua me propozimin e z. Klaus Erdman RTA në Projektin e Binjakëzimit në mbështetje të Akademisë së Drejtësisë.



Programi për praktikën e studentëve në Akademinë e Drejtësisë

Me datë 25 tetor 2017, janë pritur në takim studentet nga Kolegji “ILIRIA”, të cilat kanë përfunduar me sukses programin e praktikës, që realizohet në kuadër të bashkëpunimit mes Akademisë së Drejtësisë dhe institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë.

Gjatë periudhës së praktikës studentet patën mundësi të mësojnë për së afërmi aktivitetet e Akademisë, të njihen me funksionimin e sistemit gjyqësor dhe prokurorial me fokus në pjesën e arsimit ligjor, të përfitojnë nga

pjesëmarrja në trajnimet e Akademisë, si dhe të ndihmojnë në përgatitjen e trajnimeve dhe aktiviteteve të ndryshme si dhe hartimin e raporteve për aktivitetet e organizuara nga Akademia e Drejtësisë.

Pas përfundimit me sukses të praktikës, Koordinator i Programit në Akademinë e Drejtësisë, studenteve u shpërndau certifikata.



Seminar mbi zbatimin e KENDJ dhe garancionet ligjore për mbrojtjen kundër diskriminimit

Me 26-28 tetor 2017, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Shkollën Magjistraturës së Shqipërisë, mbështetur nga projekti i qasjes në drejtësi të UNDP-së realizoi seminarin e përbashkët rajonal mbi zbatimin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe garancionet ligjore për mbrojtjen kundër diskriminimit.



Qëllimi i organizimit të seminarit ishte shkëmbimi i përvojave në mes të gjyqësorit Kosovar dhe atij nga Shqipëria në fushën e zbatimit të vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut si dhe zbatimin e Ligjit Kundër Diskriminimit.

Seminari trajtoi kornizën ligjore dhe praktikën gjyqësore lidhur me barazinë dhe mos

diskriminimin, diskriminimi në fushën e marrëdhënieve të punës, zbatimin e KENDJ-së në Kosovë dhe Shqipëri përfshirë metodologjinë e referimit të praktikës gjyqësore së GJEDNJ-së dhe zbatimin e vendimeve të GJEDNJ-së në Shqipëri. Po ashtu u elaborua roli i gjykatave dhe Avokatit të Popullit në ndalimin e diskriminimit përfshirë dhe standardet e OKB dhe ato evropiane lidhur me barazinë dhe mos diskriminimin – rëndësia e njohjes dhe zbatimit të tyre nga sistemi i drejtësisë.

Pjesëmarrësit diskutuan praktikën e dy vendeve në zbatimin e KEDNJ-së dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së ku u prezantuan sfidat specifike të Kosovës dhe elaborimi i rasteve ku Shqipëria ishte palë në procedurën pranë GJEDNJ-së.

Pjesëmarrës në këtë seminar ishin: gjyqtarë dhe prokurorë nga Kosova dhe Shqipëria, si dhe përfaqësues nga Institucioni i Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës.



<https://ad.rks-gov.net>

**Adresa “Lagjja e Spitalit”
Rr. Muharrem Fejza p.n
Prishtinë, Republika e Kosovës**

**Tel: + 381 38 200 18 660
Fax: + 381 38 512 095
E-mail: infoad@rks-gov.net**